




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

N J O F T I M

Duke u bazuar në nenin 17 dhe në zbatim të nenit 18 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, në zbatim të nenit 4 të Rregullores për Transparencë në Komunë dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komuna, njoftohen qytetarët, shoqatat, grupet e interesit dhe bartësit e institucioneve komunale se me datën **21 maj 2015** në ora **14:00** në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, do të mbahet:

Dëgjimi Publik

PËR

RREGULLOREN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR KOMPETENCAT, PËRGJEGJËSITË DHE PUNËN E KOMITETEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT 01. NR. 1027 I DT. 29.01.2009

Qëllimi i diskutimit publik është për të krijuar opinione pozitive për projekt-rregulloren në fjalë, e cila pas zhvillimit të procedurave paraprake duke përfshirë edhe dëgjimin publik me qytetarë, do të procedohet në Komitetet përkatëse dhe në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës për miratim.

Pjesëmarrja e qytetarëve dhe grupeve të interesit (anëtarët e komiteteve përkatëse) në dëgjim publik për të shprehur mendimet e tyre do të jetë me interes, sepse me këtë projekt-rregullore rregullohet puna dhe garantohet funksionimi normal i Komiteteve të Kuvendit të komunës si trupa ndihmëse në procesin e vendim-marrjes në Kuvendin e Komunës.

Projekt-rregulloret mund t'i merreni në Zyrën Ligjore, dhe do të jetë e publikuar edhe në web faqen e komunës: www.kk.rks-gov.net/gjilan

Gjilan, 07 maj 2015

Komuna e Gjilanit